REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 688/20
Date/Datum. 05.10.20

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	24.09.2020	05.10.2020	688/20
Gjemajli Bellanica;			
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.09.2020, GOE "VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"SH.P.K" kanë parashtruar ankesë me nr: 688/20 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.P.T "BAKALLI METAL" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit "Lumbardhë në Pejë"** , me nr. të prokurimit:**635-20-4235-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Kuvendi Komunal - Pejë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës:**150 000.00** €.
Data e njoftimit për kontratë.....06.08.2020.
Data e hapjes së ofertës.....26.08.2020.
Data e njoftimit për dhënien e kontratës.....06.09.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm.....06.09.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim .....07.09.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....08.09.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: GOE "VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"SHPK"

Dispozitat e shkelura nga AK sipas GOE

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 pika1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 pika 1 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Letrën standarde për tenderues te pasuksesshëm e kemi pranuar përmes platformës elektronike , me pas kemi kërkuar qasje ne dokumentacion , pas qasjes kemi vërejtur numër të madhe te shkeljeve qe ka bere Autoriteti Kontraktues ne momentin e shpalljes se Operatorit Ekonomike N.P.T. "BAKALLI METAL"
Autoritet kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 pika 1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Ligjit te Prokurimit Publik , nga që nuk e ka vlerësuar drejtë dhe si duhet ofertën e shpallur fituese.

Autoritet kontraktues ka shpallu fitues një Operator Ekonomike , i cili ne momentin e dorëzimit te ofertës si dhe pas sqarimeve te kërkuar nuk e ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale konkretisht Dëshmi qe ka përfunduar projekte të ngjashme në tri vitet e fundit , Operatori ekonomikë ka prezantuar Aneksin duke i bashkangjitur kontrata dhe referenca me kompani private duke mos ja bashkangjitur edhe dëshmitë fletëpagesat nga banka apo dëshmi tjetër që ka arkëtuar mjete sipas Referncave të prezantuara , pas parashtrimi të Kërkesë për Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Sqarime Operatorit Ekonomike te shpallur fitues , i njëjtin Operator Ekonomik e ka ofruar dëshmi qarkullim bankar , por që ka mospërputhje të mëdha ne mes së kontratave te lidhura dhe Pagesave të pranuar dhe nuk e mbulon kërkesën ne FDT

Kontrata me kompaninë Ventius Kosova LLC është lidhur me datën 16.03.2019 dhe ka përfunduar me datën 23.12.2019 në vlere financiare 65.000,00 euro ,referencën e ka të lëshuar me datën 23.12.2019 ne vlerën 65.000,00 euro , kur analizojmë pasqyrën bankare qe na ka ofruar Autoriteti Kontraktues del që NTP Bakalli Metal ka pranuar pagesa para datës së nënshkrimit të kontratës dhe atë nga data 17.07.2017 e deri me 06.12.2018 ka pranuar mjete ne vlerë financiare 62.812.85 , ndërsa ne emër te kontratës së prezantuar ka pranuar 11.146,00 euro , duke marr për bazë analizën e lartë cekur konsiderojmë që kjo Referencë nuk e ka vlerën siç shihet por duhet ti llogaritet vetëm vlera nga data e lëshimit të kontratës e deri ne datën e përfundimit që është vlera finaicare 11.146,00 euro nga që pagesat para datës së nënshkrimit të kontratës nuk duhet ti pranohen , po ashtu ka transaksion bankare para datës së nënshkrimi të kontratës ku shihet qe NPT Bakalli i ka transefuar mjete Ventius Kosova LLC dhe atë ne datat 06.12.2018 , 04.05.2018 , 27.04.2018 si dhe 13.12.2017

Kontratën e lidhur me Devolli Co me datën 23.06.2019 e përfunduar me 13.07.2020 ne vlere financiare 185.000,00 euro dhe me reference te lëshuar me datën 13.07.2020 ne po atë vlere , Operatori Ekonomike nuk ka ofruar asnjë dëshmi bankare qe ka pranuar këto mjete , andaj konsiderojmë që kjo Referencë është e pa bazë dhe nuk ka bazë ligjore të pranohet.
Kontratën e lidhur me New Co Fabrika e Amortizatorëve sh.p.k.të lidhur me datën 10.06.2019 dhe te përfunduar me datën 01.06.2020 ne vlere financiare 69.064,00 euro dhe me reference te lëshuar me datën 01.06.2020 ne po atë vlere, në bazë të qarkullimit bankare te ofruar nuk përputhet vlera financiare e referencës nga që pagesën e parë e ka para datës së nënshkrimit të kontratës konkretisht me datën 17.08.2017 ne vlerën finaciare 13.477,60 euro si dhe dy pagesa i ka pas lëshimit të referencës me datat 26.06.2020 ne vlerën financiare 2000.00 euro ,si dhe me datën 23.07.2020 ne vlerën financiare 484.74 euro , andaj si reference duhet ti llogaritet vetëm vlera financiare 61.580.28 euro.

Kontrata e lidhur me BK-Construction shpk në vlere financiare 14.250,00 euro me daten 28.06.2019 e përfunduar me datën 12.09.2019 , me reference te lëshuar me datën 12.09.2019 ne po atë vlere , nuk ka ofruar asnjë dëshmi bankare qe ka pranuar këto mjete , andaj konsiderojmë që kjo referncecë është e pa bazë dhe nuk ka bazë ligjore të pranohet.
Kontrata e lidhur me Martius LLC ne vlere financiare 63.711,00 euro me datën 05.08.2019 e përfunduar me datën 01.06.2020 dhe me reference te lëshuar me datën 01.06.2020 ne po atë vlere , ne dëshmi e ofruara nuk përputhen me Referencën e lëshuar , në bazë të qarkullimit ka dëshmi që ka pranuar mjete financiare nga data 28.08.2019 e deri me datën 20.07.2020 ne vlere financiare 47.500,00 euro dhe pas pranimi të reference ka pranuar edhe 3.000,00 euro , andaj kjo reference duhet ti llogaritet vetëm vlera financiare 47.500,00 euro dhe jo siç e ka ofruar Reference 63.711,00 euro.
Në bazë të Analizimit të Raportit Bankarë dhe Kontratave me Referenca te dorëzuar konstatojmë qe Operatori Eknomike N.P.T. "BAKALLI METAL" ka ofruar dëshmi për përfundimi e punëve të ngjashëm gjatë tri viteve të fundit si vijon

1. Kontratën me Ventius Kosca LLC ka reference vlerën financiare 11.146,00 euro
2. Kontratën me Devolli Co nuk ka dëshmi mbi qarkullimin bankare dhe referenca është e pa bazë
3. Kontratën me New Co Fabrika e Amortizatorëve sh.p.k. ka reference vlerën financiare 61.580,00 euro
4. Kontratën me BK-Construction shpk nuk ka dëshmi mbi qarkullimin bankare dhe referenca është e pa bazë
5. Kontratën me Martius LLC ka reference vlerën financiare 47.500,00 euro

Vlera e kontratave me referenca në tri vitet e fundit 120.226,00 euro
Andaj , konstatojmë qe Operatorit Ekonomike i shpallur fitues N.P.T. "BAKALLI METAL" është i papërgjegjshëm, nga që nuk ka përmbushur kriterin siç kërkohet ne FDT Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme (punë me konstruksione metalike,) në vlerë prej 200.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe automatikisht duhet të shpallet i pa përgjegjshëm dhe të eliminohet

Autoriteti kontraktues po ashtu ka bërë shkelje të Ligji i Prokurimi Publike , ne momentin qe ka shpallur fitues Operatorin Ekonomikë N.P.T. "BAKALLI METAL" ku ky Operatori nuk i ka përmbushur kriteret siç kërkohen ne FDT Kërkesa me numër 4 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve , nuk ka ofruar dëshmi që posedon apo ka marrëveshje mbi qeren për Makineri për Zallim të Konstruksionin

Metalik andaj ne bazë të kësaj konsiderojmë që ky operator Ekonomike është i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet pasi që nuk ka përmbushur këtë kriter të dosjes së tenderit.

Operatori Ekonomike i shpallur fitues nuk ka ofruar dëshmi siç kërkohen ne pramase dhe parallogari , A-teste dhe katalogun për reflektorëve për ndriçim , duke mos ofruar karakteristika teknike siç kërkohen.

Ndërsa lidhur me pretendimin e Autoritetit Kontraktues që gjatë parashtrimit të Kërkesë për rishqyrtim nuk kemi cekur edhe emrin e partnerit të konozciumit , ju njoftojmë që për këtë procedure të prokurimit ne kemi qene lider dhe kemi pasur te drejtën e parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim nga llogaria jonë në prokurimi, po ashtu ne dosjet te tenderit bashkarish me Marrëveshje te konozciumit kemi dorëzuar edhe Autorizimin ku kompania jone autorizohet të merre të gjitha veprimet ne emër të konozciumit.
Duke u bazuar ne faktet e gjetura pas qasjes dhe të shënuar më lartë konstatojmë që Autoritet kontraktues KK Peje , ka bërë shkelje te Ligji i Prokurimi Publike në momentin e shpalljes fitues së N.P.T. "BAKALLI METAL" , kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe ta kthej lenden ne ri vlerësim duke u bazuar ne faktet e ofruara te anuloj vendimin për shpallje fitues operatorit ekonomike N.P.T. "BAKALLI METAL" , duke formuar komisioni të ri për ti vërtetuar gjetjet tona të larte shënuar të na shpalle neve si Operatore ekonomikë të përgjegjshëm.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK)
2. Regjistrimi i TVSH –së

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjatë tre vite të fundit duhet te jetë jo më pak se 300,000.00 Euro.
Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme (punë me konstruksione metalike,) në vlerë prej 200.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 50% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e fundit.

2. Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv ,me provoj pune minimum 3 vjeçare.
3. Stafi i lartë profesional që do të kyçet në projekt minimum 2 inxhinierë - Një (1) inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë (ose master)-,minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit. - Një (1) inxhinier i diplomuar i Elektros (ose master)-,minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.
4. Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Kamion vetshkarkues minimum 10 m3 Minimum 1 copë 2. Auto Vinç minimum 40 ton Minimum 2 copë 3. CNC (Pajisje për prerjen precize të metalit) Minimum 1 copë 4. Makineri për Ngjyrosje me ngjyrë elektrostatike të lëngshme Minimum 1 copë 5. Makineri për Zallim të konstruksionin Metalik Minimum 1 copë
5. Specifikimi teknik i detyrueshëm

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje
2 Certifikata e TVSH-së kopje

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të fundit.

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve. Kontratat duhet te kenë procesverbalet si dhe Referencat në të kundërtën nuk do të merën parasysh nga A.K
2. Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ketë Diplomën-kopje , vendim për Projekt menaxher i vulosur dhe nënshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri.
3. Për stafin profesional (inxhinierët) duhet të kenë Diplomat-kopje, kontrata apo parakontrata në emër të projektit dhe CV-ja e nënshkruar nga vet inxhinierët.
4. Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore , apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të pajisjeve. Njoftim Komisioni vlerësues do ta bëj edhe verifikimin e pajisjeve në vend punishte të O.E të cilët marinë pjesë në këtë Aktivitet Prokurimit.
5. Deklaratë e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
KOMUNA E PEJES shpërblen me kontratë ***N.P.T." BAKALLI METAL ",*** ne vlere totale te ofertës: **99 962,00€**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Ska

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË "VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"SHPK

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1 – GOE ankues pretendojnë qe i rekomanduari për kontratë nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-së,si dhe pas sqarimeve te kërkuara nuk e ka plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike/profesionale konkretisht dëshminë që ka përfunduar projekte te ngjashme ne tre vitet e fundit, dhe OE pretendon se ka mospërputhje te mëdha ne mes të kontratave të lidhura dhe pagesave të pranuara.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme (punë me*

konstruksione metalike,) në vlerë prej 200.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 50% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e fundit". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve. Kontratat duhet te kenë procesverbalet si dhe Referencat në të kundërtën nuk do të merën parasysh nga A.K*".

Pas analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një listë të plotësuar sipas Aneksit 6 të dosjes se tenderit ashtu siç është kërkuar,dhe ka paraqitur kontratat dhe referencat si dëshmi që janë konform DT-së. Ndërsa sa i përket mospërputhjes në mes të kontratave të lidhura dhe pagesave të pranuara,eksperti shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë si dëshmi dokumentare nuk është kërkuar një gjë e tillë andaj duke pas parasysh kërkesat e DT-së dhe dëshmitë e ofruar nga i rekomanduari për kontratë eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2 – GOE ankues pretendojnë qe i rekomanduari për kontratë nuk i ka përmbushur kriteret siç kërkohen në FDT,kërkesa me numër 4 lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve,nuk ka ofruar dëshmi që posedon ose ka marrëveshje mbi qeren për makinerinë për zallim te konstruksionin metalik.

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimit për kontratë është kërkuar: "*Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve..... Makineri për Zallim të konstruksionin Metalik Minimum 1 copë*".Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore , apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të pajisjeve. Njoftim Komisioni vlerësues do ta bëj edhe verifikimin e pajisjeve në vend punishte të O.E të cilët marinë pjesë në këtë Aktivitet Prokurimit*".

Pas analizës së dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues vlerëson që OE ka ofruar një listë të makinerisë në të cilën gjendet edhe makineria për zallim te konstruksioneve metalike (me te dhenat T 14606,prodhues SAPI GMBH), mirëpo OE për pajisjen e kërkuar nuk ka ofruar dëshminë siç është kërkuar në Dosje te Tenderit,rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se i mungon dëshmia e kërkuar ne dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3 – OE ankues pretendon qe OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare dëshmi siç kërkohen në paramas dhe parallogarit,A-teste dhe katalogun për reflektorëve për ndriçim duke mos ofruar karakteristika siç kërkohen.

Pas analizës se dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë mungon A-teste dhe katalogu për reflektorët dhe AK është dashur të kërkoj sqarime andaj ky pretendim është i bazuar dhe eksperti rekomandon që gjatë rivlerësimit konform

dispozitave te LPP-së AK mund të kërkoj sqarime.

Sqarim;
Po ashtu ne pajtim me nenin 9 paragrafi 2 te ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.*** Eksperti shqyrtues ka dhën përgjigjeje vetëm në pretendimet qe kanë qen të njëjta me ato të kërkesës për rishqyrtim.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e **OE "VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"** të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	- KK-PEJË
Panelit Shqyrtues	- OSHP
OE ankues	- "VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"